



RAPORT VJETOR

Vendi: Vithkuq
Programi: UNDP
Periudha: nentor14 - nentor15
Data e raportit 6/11/2015

Pergatit: Adad Malore

Raport per periudhen nje vjecare

1. Objektiva vjetor :

1.1 Identifikim, lancim projekti, **pasurim** dhe **ndejkje** e specializuar, produkte lokale sipas sezoneve (vjetore) perpunime artizanale Vithkuq

Identifikim situata, presantim objektivash per Komunen dhe Grupin e grave Vithkuq

Kontakte e shkembime te reja mbi grumbullimin dhe kondicionimin e produkteve lokale ne Komunen e Vithkuqit,

Shkembime Brenda dhe jashte vendit me grupin e grave per mundesi te reja bashkepunimi ne marketing dhe zgjerimi i tij.

Informacion mbi tregun dhe kerkesa specifike dhe komunikim permanent me leader e grupit te grave Vithkuq.

1.2 Animation e perforcim te grupit te grave Vithkuq dhe formime te specializuara.

Pune me grupin e grave per mundesite e reja ne grumbullim, kondicionim e zgjerim aktiviteti.

Nderhyrje eksperti ne aspect te marketing, kondicionimit dhe pasurimit (eksperte te marketingut dhe te disenjimit (elemente te marketingut: bashkerendim mes tradita dhe modernes, nje mundesi me e mire)

Katalogje mbi pasurimin e elementeve te tradites ne punime artizanale dhe mbi menyren e kondicionim/ambalazhimit (nje nxitje me shume per grumbullim - perpunim - shitje)

Hartimi I nje brochure te thjeshte promovim-komunikimi per produktet lokale aktuale

Takime per promovim produkti ne nivel local, rajonal e nderkombetar (Struge e Ulqin, disa shitje por me shume interes shkembimet mbi prodhimin dhe tregtimin)

Takim me perfaqesues te biznesit dhe te tregut Korce e Tirane per te inicuar kontrata shitje

1.3 Fuqizimi ekonomik i grupit te grave (ekonomik e social) permes blerje e shitjeve te produkteve, punimeve qe disponojne dhe njohjeve me interes reciprok

Disa shitje per promovime e ekspozime lokale e kombetare (produkte dhe punime artizanale lokale).

Blerje materiali per prodhim artizanal tradicional dhe kondicionim e paketim te produkteve dhe Shoqerimi me etiketen perkatese

Zgjerimi I games se produkteve dhe I shtrirjes gjeografike (per gjithe zonen e Vithkuqit), nje mundesi e re per te siguruar sasi, cilesi dhe llojshmeri, me shume akses per treg e me shume te ardhura per familjet e Vithkuqit

2. Misione te realizuara ndjekje dhe formim te grave per fuqizimin e tyre ekonomik e social

ADAD: Liljana ISAKAJ, Hafuz DOMI, Emanuela MECE, eksperte te jashtem per tema specifike.

3. Ceshtjet kryesore te trajtuara ne kete periudhe nje vjecare me qeverisjen vendore dhe grupin e grave Vithkuq

- **Lancimi i projektit dhe validimi i tij ne Komunen Vithkuq dhe me grupin e grave (grup qe do te strukturohet ne vazhdim)**

Kryetari i Komunes Vithkuq , vleresoi faktin qe e njejta organizate, ADAD qe ndihmoi Komunen dhe Komunitetin e Vitkuqit (13 fshatra) per hartimin e Planit Strategjik 2012- 2020, sot po ndihmon grupin I grave per te vene ne jete idete dhe propozimet e tyre ne kete Plan Strategjik. Projekti aktual eshte nje forme konkrete per inkurajimin e grave qe meren me grumbullim, perpunim te produkteve lokale por njekohesisht dhe pune dore karakteristike te zones Vithkuqit (theksojme se punimet artizanale me baze leshi kane qene dhe vazhdojne te jene te njohura ne rajon dhe ne vend). Nga ana tjetere ky projekt rrit kapacitetet e tyre per ta kthyer kete sektor ne nje sektor ekonomik e me rendesi per familjet dhe zonen.

Grupi grave ka vleresuar jo vetem aspektin material por me shume ate te shkembimit, formimit per cilesine dhe marketingun duke aspiruar qe te perfaqesojne Vithkuqin ne evenimente lokale e kombetare dhe te ndikojne pozitivisht ne terheqjen e vemendjes drejt zhvillimit lokal dhe turistik. Ato propozuan dhe vazhdimin apo zgjerimin e ketij projekti ne grumbullim te bimeve medicinale dhe **perfshirjen e te rinjve**. Per te nenvizuar grupi ka ardhur ne rritje dhe jane perfshire dhe gra me probleme shendetesore e sociale.

- **Zgjerimi i games se produkteve per cdo sezon, vjetor (cfare produktesh lokale, cfare kapaciteti per prodhim e grumbullim, cfare tregu dhe interesi ?)dhe i grupit te grave te perfshira ne projekt.**

Organizimi dhe motivimi i grave te Vithkuqit, ka dhene rezultatet e para ne zgjerim produkti qe prodhojne apo grumbullojne dhe tregun ku duan ta shesin, (per here te pare nje mundesi shitje ne nivel Komune dhe rajoni). U krijua nje komision per produktet lokale e medicinale dhe artizanale, komision me tre perfaqesuese per identifikim e keshilla per grumbullim /prodhim, drejtohet nga leader e grupit. P. SHORE dhe perfaqesuesja per monitorimin e ketij projekti per fuqizimin e grave nga komuna Vithkuq P. SUMBLLA. Jane percaktuar lloji dhe lista e produkteve per sezonin pranveror, veror dhe vjeshte (bime medicinale, nenprodukte bujqesore e blegtorale, produkte gastonomike dhe produkte artizanale) e shoqeruar dhe me nje broshure te thjeshte te ketyre produkteve si dhe kondicionimi i shoqeruar me etiketen respektive.

- **Vazhdimi dhe ndjekja e projektit ne Komunen Vithkuq dhe me grupin e grave (projekt qe merrton te vazhdohet deri ne nje strukturim iniciativash dhe grupi)**

Pergjegjesi I komanduar ne komunen Vithkuq ne vazhdim te bashkepunimit me organizaten ADAD ne drejtim te bujqesise ne nivel komune dhe ne vecanti ne frutikulture po ndjek hapat qe po ben projekti dhe po ndihmon ne menyre institucionale ne njohjen dhe promovimin e ketij grupi ne drejtim te produkteve tipike te Vithkuqit. Per kete projekt eshte kontaktuar dhe po punohet ne drejtim te ekspozimit te produktit Shoqata Kulturore Vithkuqare (shoqate per trashegimine kulturore me ndikim pozitiv ne trashegimine artizanale, gastronomike, bujqesore e me gjere). Avancimi dhe pasurimi i ketij projekti eshte nje forme konkrete per inkurajimin e grave qe meren me grumbullim, perpunim te produkteve lokale e pune dore karakteristike, formim i specializuar i ndihmon per ta kthyer aktivitetin e tyre ne te qendrueshem dhe me gjithperfshires. Rendesia sociale e ekonomike e ketij projekti qendron ne faktin se po ndjehen te vleresuara grate qe jane perfshire dhe njekohesisht po zgjerohet dhe me gra ne nevoje e me problem sociale e shendetesore. Grupi I grave po avancon cdo dite ne organizim (nje bashkepunim shume interesant ne baze fshati/lagje te Vithkuqit per produkte specifike), ka nje interesim me te madh per

trajtime te specializuara si ne drejtim te permiresimit te prodhimit te produkteve ne te gjitha hallkat e zinxhirit deri ne prekjen e te ardhurave). Propozojne vazhdimesi per ta bere te qendrueshem kete aktivitet ekonomik

- **Formimi dhe motivimi i grave te Vithkuqit, ka dhene rezultatet e para ne zgjerim produkti qe prodhojne apo grumbullojne dhe tregun ku duan ta shesin**

Jane bere disa formime per grumbullim, perpunim, kondicionim e marketing te produkteve lokale e medicinale dhe artizanale, komision me tre perfaqesuese per identifikim e keshilla per grumbullim /prodhim (mbrojtja e natyres dhe grumbullimi me cilesi i bimeve dhe produkteve)

Drejtimi dhe pergjegjesia nga leader e grupit. P. SHORE dhe perfaqesuesja per monitorimin e ketij projekti per fuqizimin e grave nga komuna Vithkuq P. SUMBLLA. Jane percaktuar lloji dhe lista e produkteve per cdo sezon(bime medicinale, nenprodukte bujqesore e blegtorale, produkte gastonomike dhe produkte artizanale) e shoqeruar dhe me nje broshure te thjeshte te ketyre produkteve si dhe kondicionimi i shoqeruar me etiketen respektive.

- **Formime e ekspertise te specializuar per grupin e grave te Vithkuqit, nderhyrje ekspertesh mbi marketingun dhe dizanjen e shoqeruar kjo me katalogje respektive dhe koherente**

Pas nje pune identifikuese dhe problematikes se ngritur gjate takimeve ne baze fshat/lagje te Vithkuqit eshte nderhyre me ekspertise ne drejtim te permiresimit te prodhimit dhe te grumbullimit (e perfshire dhe tema e ekonatyres) dhe sidomos kondicionimi dhe format e marketingut. Jane realizuar formime ne disa etapa mbi marketingun dhe permiresimin e elementeve te kondicionimit per produktet lokale dhe te punimeve artizanale. jane blere materiale ne funksion te ketyre rekomandimeve dhe jane shperndare katalogjet mbi punimet artizanale me elemente moderne dhe destinacion te orientuar per grupet e vogla qe bashkepunojne ne kete teme si dhe katalogje te kondicionimit te bimeve medicinale apo produkteve lokale qe lejojne nje promovim, shitje dhe te ardhura me te mira. Jane diskutuar disa elemente te marketingut te cilet perbejne njekohesisht bazen e nje plan marketingu te specifikuar per produktet lokale tradicionale Vithkuq. Ekspertet e fushes kane nenvizuar rendesine e cilesise qe ne grumbullim e prodhim te produkteve qe tregu te beje diferencen me produkte tjera dhe njekohesisht gjate kondicionimit te shoqerohet me nje pershkrim te qarte destinacioni i produktit (cfare vlerash ? cfare ndikimi ? karakteristike e cilesi tjera ?)

- **Zgjerimi i grupit te grave dhe perfshirja e tyre ne forume zhvilluese ekonomike e sociale.**

Takimet, shkembimet dhe formimet e organizuara nga ADAD, eksperte te marketingut e te kondicionim dizanj kane bere qe interesi per perfshirje dhe bashkepunim te jete me i madh dhe sigurisht me aspekte sociale e ekonomike te ndryshme. Ky diversifikim i grupit dhe iprodukteve locale e artizanale tradicionale te Vithkuqit eshte nje shenje avancimi dhe zhvillimi si nga ana e tyre per prodhimin ashtu dhe nga ADAD per kontaktet e marra me perfaqesues te biznesit local e rajonal me shoqaten e kultures se Vithkuqit, me perfaqesues te pikave te tregtimit sipas tradites dhe origjines etj.

Pune e lavderueshme nga dy perfaqesueset leader ne Vithkuq per venien ne dijeni dhe krijimin e lidhjeve mes grave rreth produktit. P. SHORE e P. SUMBLLA, ato kane animuar dhe takime ne baze fshati per te transmetuar eksperiencen e marre ne Shkembimin ne Struge te Maqedonise ne gusht 2015, ku Vithkuqi u perfaqesua me nje grup prej 20 vetash. Nga ana tjeter eshte bere pjese e projektit dhe eksperiencia e grupit te grave Ersek ku shkembimi mes perfaqesueve leader te Vithkuqit dhe te Ersekës ka konsistuar vecanerisht ne marketingun e produkteve

- **Konsolidim i listes apo games se produkteve lokale tradicionale ne Vithkuq dhe zgjerimi i tij gjeografikisht (ne zonat me te largeta te Vithkuqit)**

Nje program vizitash dhe identifikimesh jane bere nga ADAD ne shoqerim te Lidereve e grupit te Grave Znj. Pavlina SHORE dhe nga perfaqesuesja e Komunes Vithkuq (artizane njekohesisht) Znj.Pavlina SUMLLA per te krijuar nje kalendar produktesh sezonale e vjetore per Zonen e Vithkuqit. Jane realizuar postera, flete palosje e etiketa ne drejtim te promovim komunikimit per te mire vleresuar produktet e zones Vithkuq. jane marre idete gjate vizitave si dhe propozimet ne takime per tu perfshire ne kete kalendar i cili pervec vleresimit te produktit lokal i jep shtytje dhe fuqizimit ekonomik te grave.

- **Aktivite ekspozimi per produktet lokale tradicionale te Vithkuqit, pasurimi i qendres per ekspozim dhe marketing te produkteve, vene ne dispozicion nga Komuna Vithkuq ne ambientet e saj.**

Jane realizuar disa aktivite me pjesmarje direkte te nje perfaqesie te grave te Vithkuqit per prezantim e shitje te produkteve te tyre por nga ana tjetere eshte bere nje prezantim i produkteve ne pika te ndryshme ne nivel lokal e kombetar per te shijuar dhe njohur keto produkte dhe per te kjuar mundesi lidhjesh mes te interesuarve dhe grupit te grave. Jane prezantuar ne panaiare kombetare e nderkombetare, (ex. panair i trevave shqiptare dhe ne kuader te festivalit folkloric)

4. Konkluzione

- Shoqerim I specializuar I iniciativave per vleresim te prodhimeve dhe produkteve tradicionale te Vithkuqit
- Avancim e zgjerim per fuqizimin ekonomik te grave Vithkuqare
- Mirkuptim e bashkerendim parteneresh : **Gr. Grave-Aktore – ADAD**
- Formim e integrim te pers. te kontaktit P. SUMLLA dhe P. SHORE
- Dy katalogje per artizanatin koherente dhe marketingun
- Qendrueshmeri e bashkepunim sipas produktit (medicinal, gastro. artizanal)
- Fiche teknike; produktet lokale tradicionale Vithkuq.
- Nje vazhdimesi bashkepunimi me ekipin e komanduar ne komunen Vithkuq
- Zgjerim i games se produkteve te punuara dhe grumbulluara nga grate
- Nje liste produktesh per ekspozim e shitje dhe nje etikete identifikuese
- Nje grup i strukturuar dhe nje perspective e re per grate e Vithkuqit
- Disa shitje dhe nje “Emer”, piknisje e bukur per tu kthyer ne tradite

5. Aktivite ne vazhdim

- 5.1. *Identifikime te reja dhe perfshirje me te gjere (gra e te rinj)*
- 5.2. *Futja e ndjenjes se solidaritetit permes perfshirjes se grave apo te rinjve me probleme (shitje solidare e te ndershme), mbeshitetje per nxitje e motivim*
- 5.3. *Ekspozime ne panaiare, shkembime e kontrata me biznesin*
- 5.4. *Shoqerim aktiviteti te produkteve tradicionale, teknik e organizativ*
- 5.5. *Formime ne vazhdim mbi marketingun, modelimin dhe kondicionimin.*
- 5.6. *Formime mbi vleresimin e mjedisit dhe te produkteve tipike(lidhja e ketij programi me edukimin mbi njedisin te grupeve te perfshira dhe te rinise ne shkolla)*